

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sidorela Vatnikaj: Bashkimi kundër korrupsionit dhe krimit është i vetmi që mund të bëjë ndryshimin në S hqipëri - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/sidorela-vatnikaj-bashkimi-kunder-korrupsionit-dhe-krimit-eshte-i-vetm i-qe-mund-te-beje-ndryshimin-ne-shqiperi/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:02:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	21 shtator 2026, 18:06:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d94592c59f249127e21bf4e37032f4c2d164d57908be8a9f7e60bc71dfc0f9dc
TEKSTI	5e5effe1e3213d2a4905e477068ee91fe1c18620d778a51bf42417e8a9f879dc
PAMJA	7b16e5e280349b839c2a4f479a2f46b2445d2e9ea1cebb5f2c1309f8005aa6ac

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	95a188fab99695391f12d99c917a764ca2d16a29068eb2cffea0d15e43e3457d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/95a188fab99695391f12d99c917a764ca2d16a29068eb2cffea0d15e43e3457d

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Sidorela Vatnikaj: Bashkimi kundër korrupsionit dhe krimit është i vetmi që mund të bëjë ndryshimin në Shqipëri

by Sport Sport — September 21, 2026 in Aktualitet, Politike

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Në ditën e 114-të të protestës përpara godinës së Kryeministrit, aktivistët dhe qytetarët kanë vijuar qëndresën e tyre duke lëshuar akuza të forta ndaj pushtetit politik. E pranishme në shesh, aktivistja Sidorela Vatnikaj theksoi se kjo lëvizje qytetare ka arritur të bëjë bashkë shqiptarët përtej çdo ndasie kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Vatnikaj rikujtoi zanafillën e protestës dhe theksoi se përpjekjet e pushtetit për t'i frikësuar apo për t'i etiketuar kanë dështuar përballë besimit dhe bashkimit qytetar.

"Shqiptarët janë bashkuar në këtë shesh përtej çdo ndasie. Bashkimi kundër korrupsionit dhe krimit është i vetmi që mund të bëjë ndryshimin në Shqipëri për Shqipërinë që kanë ëndërruar gjyshërit tanë dhe që punojmë ne sot. Kjo protestë nisi me shkakun e dhunës së ushtruar në Zvërnec ndaj një protestuesi! Ne distancohemi nga çdo formë intimidimi e dhune që ndodh në protestë ose jashtë saj sepse kemi mësuar në 114 ditë protestë se vetëm besimi të njëri-tjetrit dhe bashkimi me njëri-tjetrin dhe dashuria na bën më të fuqishëm kundër shtetit të krimit, oligarkisë ekonomike dhe mediave të kapura!"

Më tej, aktivistja denoncoi gjuhën e përdorur nga kryeministri Edi Rama si dhe makinerinë e patronazhimit që tentoi të mbulonte degradimin e shërbimeve publike në vend.

"Në 114 ditë kërkesat tona jo vetëm që nuk janë plotësuar por janë shtuar! Mjafton të shikosh si kryeministri në vend që të dëgjonte kërkesat tona filloi të na quante agjentë të huaj, dhe duke mos na parë në sy neve, shqiptarët që kishim shqetësim kriminel, korrupsionin e oligarkinë ekonomike! Kush do e besonte se do ja dilnim edhe valës së sulmit të korrikut kur u sulën të gjithë sistemi i patronazhimit për të na mbushur mendjen se spitalet nuk janë aq keq, se shkollat nuk janë aq të pasigurta, se sistemi që ka ndërtuar Edi Rama është i drejtë dhe meritokratik..."

Ajo nënvizoi se sistemi politik ka mbetur i njëjtë prej dekadash, duke vjedhur shtresat më të pamundura për t'u shërbyer oligarkëve.

"...por në 36 vjet ne kemi parë që ka qenë e njëjta fytyrë e pushtetit, ajo që fut dorën në xhepin e të varfërve për t'ia dhënë të pasurve, ajo që e lë spitalin pa serume e pa ilaçe, ajo që e lë shkollën pa mësues se i kthen në profesorë të sistemit të patronazhistëve. Ne kemi thënë mjaft është mjaft! Jemi këtu sepse kemi zgjedhur të jetojmë në vendin tonë dhe shoqërinë tonë ta kthejmë në shoqëri të parimeve të së drejtës!"

Në përmbyllje të fjalës së saj, Sidorela Vatnikaj u ndal te kërkesat kryesore politike të sheshit, duke goditur drejtpërdrejt të dy krahët e klasës së vjetër politike në Shqipëri.

"Në 114 ditë kërkesat tona fillestare mbeten të pandryshuara! Kërkojmë dorëheqjen e Edi Ramës dhe gjithë

TË FUNDIT

Thirrja e Gent Prognit për qytetarët: Nesër në 09:00 te Kuvendi, dilni për familjen tuaj. Nëse jemi shumë, do ju dridhen këmbët

SEPTEMBER 23, 2026

Arrestohet Shpëtim Aliu në Rusi, një nga "kokat" e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të kokainës

SEPTEMBER 23, 2026

Ambasadoria e BE takohet me kryetaren e KLP: Një sistem i fortë drejtësie është thelbësor për të ardhmen e Shqipërisë

SEPTEMBER 23, 2026

Pankartat ironizuese: "Nga Belinda te SHISH-i, krejt ekipi në pranga! Jep dorëheqjen Edi Rama, nuk të shpëton dot as banda

SEPTEMBER 23, 2026

Edison Lika: Qëndresa çdo ditë në shesh po gërryen pushtetin e qeverisë, kryeministri do të bjerë si tigër prej letre

SEPTEMBER 23, 2026

Aktivistja i këndon këngë deputetes së PS: Zegjine o Zegjine, ti nuk di të numërosh, shko në shkollë të mësosh! Plas debati

SEPTEMBER 23, 2026

"Shqipëria kërkon revolucion"/ Sot dita e 116-të e protestës, qytetarët të vendosur deri në largimin e qeverisë: Rama, jep dorëheqjen!

SEPTEMBER 23, 2026

Arrestohet polici në Klos, dyshohet se ushtroi dhunë ndaj një vajze dhe vëllait të mitur të saj

SEPTEMBER 23, 2026

Berisha: Balluku ka vjedhur miliona euro, ndërsa Lubia e SHISH sigurinë kombëtare! Qeveria ka marrë goditjen më të rëndë

SEPTEMBER 23, 2026

Gazetari trondit me deklaratën: Dyshime të forta për lidhjen e Neritan Nallbatit me Ergys Agasin

SEPTEMBER 23, 2026

kabinetit qeveritar! Kemi parë se si pushtetin e kanë mbajtur dy fytyra dhe dy parti, klasa e vjetër politike! Një kërkesë thelbësore është që kryeministri pas kësaj proteste të mund të zgjidhet vetëm për dy mandate gjatë gjithë jetës së tij politike!"

Ajo përfundoi fjalën e saj me thirrjen e prerë për hetimin dhe ndëshkimin e krerëve të politikës shqiptare: "Kur thoshim se këtë vend e kanë mbajtur dy fytyra, janë dy fytyra që kanë edhe emra: Sali Berisha dhe Edi Rama. Thirrja për t'i dhënë fund këtij monopol jo vetëm, por edhe hetimin dhe çuarjen në burg të dy autokratëve, ndaj edhe sot si ditën e parë kërkojmë: Rama në burg, Berisha në burg!"

Previous Post

Aktivisti Edison Lika: Të shfuqizohet paketa e maleve dhe ligji për investitorët strategjikë, nuk ndalemi pa dorëheqjen e Ramës!

Next Post

SPAK mbyll hetimet për Ervin Matën, akuzohet për trafikimin e 250 kilogramë kokainë



Sport Sport

report.al

REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencia dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT

E rëndë në Dibër, 22-vjeçarja mbytet në lumin Drini i Zi

0 SHARES

01



Është studente ekselente, e birësuar nga një çift grek/ Trondit avokati: Bleona Mata është gjallë

0 SHARES



Falsifikime dhe shpërdorim detyre, pezullohen 2 zyrtarë në Tiranë

0 SHARES

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.